

# webermur stokryl

## Stuko patinimi me bazë çimento

### ■ Përshkrimi

**webermur stokryl** është një material i imët patinimi me bazë çimento të bardhë.

### ■ Avantazhet

Përgatitet dhe aplikohet lehtësisht.  
Ekstremisht i bardhë dhe shumë i imët  
I përshtatshëm për aplikime të brendshme dhe të jashtme.

### ■ Përdorimi

webermur stokryl përdoret për suvatimin e imët të mureve dhe tavaneve, në ambiente të brendshme dhe të jashtme, të thata dhe pa lagështirë. I përshtatshëm për përdorim në bazamentet më të lëmuara si betoni, fino apo pllakat për ndërtimet e thata. Rezultati përfundimtar i murit dhe i tavanit do të jetë një sipërfaqe e rrafshët, ekstremisht e bardhë dhe e lëmuar.

### ■ Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamenti ku do të aplikohet webermur stokryl, duhet të jetë i fortë, i niveluar, i thatë dhe i pastër. Në rast të bazamenteve të vjetra është e këshillueshme që sipërfaqja të paratrajtohet me astarin / bazën e përshtatshme për të përforcuar sipërfaqen paraprakisht.

### ■ Udhëzime mbi aplikimin

Përzjerja e produktit duhet të bëhet në një enë të pastër. Përmbajtjes së thesit prej 25kg është e nevojshme t'i shtohet 9-10 litra ujë, duke e përzjerë me përzjerës elektrik, me numër të ulët xhirosh derisa të përfitohet një masë homogjene, pa kokrriza.

Koha optimale e përzjerjes nuk duhet t'i kalojë 5 minutat. Masa e përgatitur duhet të aplikohet brenda 1 ore, me anë të mallës metalike në një ose dy shtresa me trashësi maksimale 1,5 - 2 mm secila. Këshillohet që për aplikimin e shtresës së dytë të pritët që shtresa e parë të ketë arritur tharjen dhe fortësinë e nevojshme për aplikimin e shtresës së dytë. Pasi është arritur tharja totale e materialit – pas 24 orësh nga aplikimi i shtresës së dytë, nëse është e nevojshme mund të fërkohet sipërfaqja ku është aplikuar materiali me letër zmerile të imët, për t'i dhënë asaj një pamje më uniforme dhe të lëmuar.

### ■ Konsumi

1 kg/m<sup>2</sup>

### ■ Paketimi

25 kg / thes  
1350 kg / paletë

### ■ Ngjyra

E bardhë

### ■ Veglat

Për miksim: mikser elektrik  
Për aplikim: mallë metalike

### ■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

*\*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*